

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIKSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Niveli Org. Org. Unit Nr. Çështje Përfaqësues NoPages	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. Data Datum Date
5A-02- -04-	2578-2/23 22.02.24
PËRSHITJE / A No.1	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	05.02.2024
REFERENC-Ë:	23/2578/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"ABI" SH.P.K. Prizren Qumështore ne Prizren
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore



Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "ABI" SH.P.K. Prizren, me Nr. Prot. 23/2578/MMPHI dhe ka vendosur si ne Vendim per Leje Mjedisore te bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/2578/MMPHI
Datë: 05.02.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "ABI" SH.P.K. Prizren, pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: qumështoren në ngastrën kadastrale nr. 6939, zona kadastrale Prizren, Komuna e Prizrenit.

2. Operatori obligohet:

- 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. Vlerat e cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;
- 2.3. Raporti i rezultateve të cilësisë së ajrit sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPHI-së;
- 2.4. Vlerat e nivelit të zhurmës të jene në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;
- 2.5. Të respektohen kushtet e përcaktuara me Lejet Ujore për shfrytëzim dhe shkarkim të ujit;

- 2.6. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në;
- 2.7. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor që është përgjegjës për mjedis;
- 2.8. Për zgjerim te kapacitetit dhe ndryshim te veprimtarisë, operatori obligohet te njoftoj MMPHI-ne.
- 2.9. Afati i lejes Mjedisore është për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga dita e lëshimit te këtij vendimi.

A r s y e t i m

Është shqyrtuar kërkesa për Leje Mjedisore për operatorin "ABI" SH.P.K. Prizren, për veprimtarinë: qumështoren në ngastrën kadastrale nr. 6939, zona kadastrale Prizren, Komuna e Prizrenit.

Operatori ka bashkangjitur dokumentacionin:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 12/954/1-ZSP-107/12 të lëshuar me dt. 11.05.2012;
- ARPL- Leje Ujore për Shfrytëzim te Ujit me Nr. 7223/22 – ZSP – 2023, te lëshuar me dt. 28.02.2023;
- ARPL- Leje Ujore për Shkarkim te Ujit me Nr. 7225/22 – ZSP – 2023, te lëshuar me dt. 28.02.2023;
- Komuna e Prizrenit- Informim sipas HZK- se me nr. prot. 04-353/01-161426, te lëshuar me dt. 20.01.2023;
- Komuna e Prizrenit- Pëlqim për ushtrim te veprimtarisë afariste me Nr. 17/334/333, te lëshuar me dt. 15.06.2023;
- Kontrate mbi ofrimin e shërbimeve ne grumbullimin e mbeturinave me Kompaninë Regjionale për Mbeturina "Ekoregjioni" SH.A. me nr. prot. 01-12/58, te lëshuar me dt. 31.01.2023;
- Raporti i Emisioneve në ajër tek oxhaku i kaldajës;
- Raporti i Pluhurit tek oxhaku i kaldajë;
- Raporti i Zhurmës.

Andaj bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar dhe plotësuar nga pala dhe gjendjes faktike duke përfshi shikimin ne vend me zyrtaret profesional, sipas legjislacionit ne

fuqi për mjedisin dhe Udhëzimit Administrativ të MMPHI- se Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore janë paraqitur kushtet si ne dispozitiv.

Sipas Ligjit Nr. 03/L – 025 për Mbrojtjen e Mjedisit;

Sipas Ligjit Nr. 02/L – 102 për Mbrojtje nga Zhurma;

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2018 për Procedurat e Lejes Ujore dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2022 për Kushtet, Mënyrat, Parametrat dhe Vlerat Kufizuese të Shkarkimit të Ujërave të Ndotura në rrjetin e Kanalizimit dhe Trupin Ujor.

Afati i përcaktuar i lejes mjedisore në dispozitiv është përcaktuar, komfor nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje të Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i 'dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Prizren;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA OF KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRITVE ÇMËDITJE KËRPUT, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	23/2578-2/23
Nr. i Faqeve Be Stranica	1
Nr. i Prot. Prot. No.	2578-2/23
Datë Date	06.02.24
PRISHTINË / A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Enviroment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjes e Mjedisit dhe Ujërrave / Departament za Zaštitu Sredine i Voda / Department of Environment Protection and Waters

REFERENC-Ë:	23/2578/237/MMPHI-DMMU
DATË/A:	05.02.2024
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
CC:	Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Fatlje Buza, kryesuese e komisionit për Leje Mjedisore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje lidhur me Leje Mjedisore për operatorin "ABI" SH.P.K. Prizren Qumështore ne Prizren

Te nderuar,

Bashkëlidhur gjeni lëndën me nr. Protokolli: 23/2578/237/MMPHI-DMMU, të operatorit "ABI" SH.P.K. Prizren, për qumështoren ne Prizren.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Životnu Sredinu i Vodu /
Department of Environment Protection and Water

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENC-Ë:		23/2578/237/ MMPHI-DMMU			
PËR/ZA/TO:		Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI			
CC:		Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së			
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		Komisioni për Leje Mjedisore			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Përgjigje ne kërkesën e operatorit "ABI" SH.P.K. Prizren Qumështore ne Prizren			
Nr. i zyrës:	1517	Lokacioni:	Ish pallati i mediave	Data:	05.02.
Br. kancelarije:		Kucni:	Rilindja, Prishtinë.	Datum:	2024
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					☐
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☒
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☒
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					☐
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					☒
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					☒
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					☒
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuari Sekretar,

Komisionit për Leje Mjedisore i emëruar me Vendimin Nr. 7416/23, të dt. 22.12.2023, duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L- 025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe neni 9 i Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, në afatin e paraparë ligjorë, jep këtë Mendim Profesional:

Operatori "ABI" SH.P.K. Prizren, ka aplikuar me Nr. Prot. 23/2578/237/MMPHI-DMMU për tu pajisur me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: qumështoren në ngastrën kadastrale nr. 6939, zona kadastrale Prizren, Komuna e Prizrenit, sipas Pëlqimit Mjedisor me Nr. 12/954/1-ZSP-107/12 të lëshuar me dt. 11.05.2012.

Komisioni për Leje Mjedisore ka realizuar vizite te operatori, për verifikimin e gjendjes ne vende tek operatori me dt. 10.08.2023.

Janë verifikuar proceset teknologjike te prodhimit me kaldajën e djegies e cila i plotësonte teknikat e mira te mundshme si dhe kanalet e grumbullimit te ujit nga derdhjet ne hallën e prodhimit.

Verifikimi i shkarkimit te ujerave dhe trajtimi i tyre sipas kriterëve me Leje Ujore, te pajisur me impiantin për trajtimin e ujerave te ndotura.

Janë verifikuar pikat e mundshme te krijimit te zhurmës te cilat kane ne nivelin e lejuar me qe objekti gjendet ne pjesën e frekuentuar nga qytetaret.

Te gjeturat janë paraqitur ne procesverbal ne te cilin është nënshkruar nga anëtarët pjesëmarrës për vëzhgimin ne vend dhe operatorit.

Komisioni, pas realizimit te vizitës në teren ka kërkuar nga operatori, plotësimin e dokumentacionit dhe kushteve te cekura me poshtë:

- Plotësimi i pjesës tjetër të tarifës ne përputhje me vendimin e tarifave Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022;
- Raporti i Emisioneve në ajër tek oxhaku i kaldajës;
- Raporti i Pluhurit tek oxhaku i kaldajës;
- Raporti i Zhurmës;
- Kontratën me Kompaninë e Mbeturinave.

Operatori, ka sjell informatat shtesë sipas kërkesës te komisionit për Leje Mjedisore.

Komisioni, pas këtyre gjetjeve ne teren dhe kontrollimin e pranimi te dokumenteve shtese, ne takimin e mbajtur me date: 18.01.2024, në përbërje prej tre (3) anëtareve, unanimisht ka ardhur ne përfundim qe operatori mund te vazhdoj veprimtarinë duke iu përmbajtur kriterëve te përcaktuara ne këtë vendimin për Leje Mjedisore sipas legjislacionit ne fuqi.

Bashkangjitur këtij Mendimi Profesional gjeni edhe propozim vendimin për Leje Mjedisore.

Komisioni:



Fatlije Buza, kryesuese

Adem Tusha, anëtar

Përparim Terziu, anëtar

Fatmir Bytyqi, anëtar

Mentor Shala, anëtar

Gjendet ne pushim mjekësor.

Nuk ka qene prezent ne takim.

